

LIGJ
Nr. 10 218, datë 4.2.2010

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.3.2005 "PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE PËR DËRGIMIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE JASHTË VENDIT"

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, në fund të pikës 3 shtohen fjalët "apo nga Bashkimi Evropian".

Neni 2

Në fund të nenit 4 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Autoritetet kompetente për dërgimin e njësive ushtarake në operacione ushtarake jashtë vendit, në çdo rast, në aktin e dërgimit duhet të përcaktojnë misionin dhe mandatin e këtyre forcave. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në zbatim të misionit dhe mandatit të përcaktuar, miraton rregullat e angazhimit për këto njësi ushtarake.".

Neni 3

Neni 7 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 7

Operacionet ushtarake ndërkombëtare të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja apo Bashkimi Evropian

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, vendos për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionet e përcaktuara në pikën 3 të nenit 3 të këtij ligji, rast pas rasti, duke përcaktuar misionin, nivelin e pjesëmarrjes, kohëzgjatjen e këtij operacioni, si dhe çdo element tjetër të domosdoshëm për mbarëvajtjen e operacionit ushtarak.

2. Dërgimi i njësive ushtarake shqiptare, sipas këtij neni, bëhet vetëm në rastet kur, paraprakisht, është arritur një marrëveshje ndërkombëtare për statusin e forcave ushtarake shqiptare në vendin ku kryhet operacioni ushtarak.".

Neni 4

Në nenin 8, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Vendimi për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitje e në veprimtari ushtarake ndërkombëtare jashtë vendit merret:

- a) deri në nivel kompanie, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;
- b) mbi nivel kompanie, me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 5

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

- 1. Në pikën 1 fjalët "me pëlqimin paraprak të Kuvendit" hiqen.
- 2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 6

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

Neni 10

Emërimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare

Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë emërohet në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes."

Neni 7

Në titullin e nenit 13 shtohen fjalët "apo Bashkimi Europian".

Neni 8

Në nenin 14, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Vendimi për zhvillimin dhe pjesëmarrjen e forcave ushtarake të huaja në stërvitje të përbashkëta ushtarake ndërkombëtare, në veprimtari të organizuara, të autorizuar ose të drejtuara nga NATO-ja, Bashkimi Europian apo vendet e tjera, në territorin e Republikës së Shqipërisë, për numër të përgjithshëm pjesëmarrësish, merret:

- a) deri në 500 veta, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes;
- b) mbi 500-1000 veta, me vendim të Këshillit të Ministrave;
- c) mbi 1000 veta, me ligj nga Kuvendi."

Neni 9

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

- 1. Në pikën 1, fjalët "me pëlqimin e Kuvendit" hiqen.
- 2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 16, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

"2. Dhënia e lejes së tranzitimit për forcat ushtarake të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendet anëtare të PfP SOFA bëhet me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes. Urdhri u bëhet i ditur menjëherë autoriteteve përkatëse, të cilat marrin të gjitha masat për mundësimin sa më të

shpejtë të tranzitimit. Kur shtetet, që kërkojnë lejen për tranzitim për forcat e tyre ushtarake, nuk janë anëtare të NATO-s apo vende anëtare të Pfp SOFA, dhënia e lejes së tranzitimit bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave."

Neni 11

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6430, datë 24.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi